



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-042

Prishtinë, më 6 dhjetor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 6 DHJETOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit,

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq dhe Duda Balje.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica,

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca,

Nga OSBE: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 nëntor 2011,
2. Plotësimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 7 dhjetor 2011,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 nëntor 2011

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 nëntor 2011, u miratua pa vërejtje.

2. Plotësimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare, më 7 dhjetor 2011

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që rendi i ditës për mbledhjen plenare, më 7 dhjetor 2011, të plotësohet edhe me këtë pikë:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, të invalidëve, të veteranëve, të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të familjeve të tyre.

Kryesia, njëkohësisht vendosi që më datë 8 dhjetor 2011, Kuvendi të mbaj mbledhjen e veçantë, me të vetmen pikë të rendit të ditës, si në vijim:

1. Adresimi i Presidentes së Kosovës, znj. Atifete Jahjaga, deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Ndërsa, me kërkesë të kryetarit të Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabgoci, Kryesia vendosi t'i propozojë Kuvendit që shqyrtimi i parë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit, të hiqet nga rendi i ditës në mbledhjen plenare të datës 7 dhjetor 2011.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Shqyrtimi i njoftimeve për skadim mandati të anëtarëve të Komisioneve, Bordeve dhe Këshillave të Organeve të Pavarura

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me njoftimet e cekura më lartë, nxori dy përfundime, si në vijim:

P Ë R F U N D I M (I)

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që, në afatin më të shkurtër të mundshëm dhe në pajtim me ligjin, të ndërmarrë veprimet për parashtrimin në Kuvend të propozimeve për emërimin e anëtarëve të bordeve, të këshillave dhe të komisioneve të organeve të pavarura, për t'i emëruar Kuvendi i Republikës së Kosovës:

- a) Propozimin për kryetarin dhe një anëtar të Bordit të Autoritetit të Konkurrencës së Kosovës,
- b) Propozimin për kryesuesin dhe një anëtar të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, dhe
- c) Propozimin për dy anëtarë të Agjencisë Kosovare të Pronës.

P Ë R F U N D I M (II)

1. Ngarkohen komisionet parlamentare që, secili nga fushëveprimi i vet, ta njoftojnë Kryetarin e Kuvendit së paku 60 ditë para përfundimit të mandatit të kryetarit dhe të anëtarëve të organeve të pavarura, të emëruara nga Kuvendi.

2. Kryetari i Kuvendit do të kërkojë nga propozuesi që, në afatin më të shkurtër të mundshëm dhe në pajtim me ligjin, të ndërmarrë veprimet për parashtrimin në Kuvend të propozimeve për emërimin e anëtarëve të bordeve, të këshillave dhe të komisioneve të organeve të pavarura, të emëruara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

3. Me datën e skadimit të mandatit për kryetarë dhe anëtarë të organeve të pavarura, pushojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet e tyre. Të gjitha veprimet e ndërmarra pas datës së skadimit të mandatit paraqesin shkelje ligjore.

3.2 Përgatitjet për shënimin e 10 - vjetorit të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Sekretari njoftoi në hollësi Kryesinë e Kuvendit lidhur me përgatitjet që kishte bërë Administrata e Kuvendit për shënimin e 10-vjetorit të punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryesia, lidhur me mbulimin e shpenzimeve për shënimin e 10-vjetorit të punës së Kuvendit, mori këtë:

V E N D I M

Të gjitha shpenzimet për organizimin e shënimit të 10 - vjetorit të punës së Kuvendit mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Të ndryshme:

4.1 Njoftimi i Grupit Parlamentar të LDK-së për tërheqjen e nënshkrimeve të deputetëve të këtij grupi nga nisma legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Kryesia u njoftua me qëndrimin e Grupit Parlamentar të LDK-së për tërheqjen e nënshkrimeve të deputetëve të këtij grupi, që ishin nënshkruar për nismën legjislative për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

4.2 Njoftimi i Komisionit për Legjislacion lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, nga data 8-11 nëntor 2011

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Legjislacion, të realizuar në Shqipëri, më 8-11 nëntor 2011.

4.3 Njoftimi i Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Finlandë, nga data 13-16 nëntor 2011

Kryesia u njoftua për vizitën e Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media , të realizuar në Finlandë, më 13-16 nëntor 2011.

Pika shitesë:

1. Kërkesa e Organizatës Down Syndrome Kosova (OJQ DSK) për përkrahje financiare

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lartë, mori këtë:

V E N D I M

I lejohet ndihmë financiare Organizatës Down Syndrome Kosova (OJQ DSK), në shumën prej **1.100 euro**, për zbatimin e dy programeve bazike për komunitetin me sindromin down- programi i intervenimit dhe edukimit të hershëm dhe programit X-21, që u dedikohet të rinjve dhe të rriturve me sindromin down.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:30** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.